

FTESË

Konventa Kombëtare për Integrimin Europian Grupi i Punës III (Bujqësia dhe Mbrojtja e Konsumatorit)

Sesion 5, Tema: Themelimi, organizimi dhe funksionimi i rrjetit të të dhënave të kontabilitetit në fermë (FADN) - praktikat më të mira nga Sllovakia

22 qershor 2021, 11:00 – 12:30

Format Hibrid - Grand Hotel Tirana / Platforma ZOOM

Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në partneritet me Slovak Foreign Policy Association, me mbështetjen financiare të SlovakAid kanë kënaqësinë t'ju ftojnë në Sesionin 5 të Grupit të Punës III më temë: *“Themelimi, organizimi dhe funksionimi i rrjetit të të dhënave të kontabilitetit në fermë (FADN). Praktikrat më të mira nga Sllovakia”*

Me qëllim krijimin e urës së bashkëpunimit mes institucioneve shtetërore dhe shoqërisë civile e njëkohësisht forcimin e kapaciteteve në të dy sektorët, rikthehet Konventa për Integrimin Europian 2019-2021, zbatuar nga Lëvizja Europiane në Shqipëri në bashkëpunim me Ministrinë e linjës dhe institucione të tjera shtetërore pas zhvillimit të suksesshëm të saj në periudhën 2014-2016. **Konventa për Integrimin Europian** përfaqëson një iniciativë që ka si qëllim të institucionalizojë debatin publik lidhur me çështjet e BE, bazuar në partneritetin mes qeverisë dhe institucioneve publike, shoqërisë civile si dhe organizatave të biznesit; të forcojë aftësitë e ekspertëve në negociatat lidhur me Integrimin Europian; si dhe të transferojë eksperiencën sllovake në fushën e ndërtimit të institucioneve demokratike dhe dialogut të përhershëm profesional.

Fillimisht, ky model unik është aplikuar dhe zhvilluar me sukses nga Slovak Foreign Policy Association gjatë vitit 2003-2007 e më pas zbatuar në Serbi, B&H, Mal të Zi, Maqedoni e Veriut. Në kuadër të Konventës në Shqipëri, janë ngritur disa Grupe Pune sipas kapitujve të negociatave me BE: **GP I: Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore (Kapitulli 23); GP II: Drejtësia, Liria, Siguria (Kapitulli 24); GP III: Bujqësia dhe Mbrojtja e Konsumatorit (Kapitulli 11,12 & 28); GP IV: Fondet Strukturore (Kapitulli 22); GP V: Tregtia dhe çështjet ekonomike (Liritë e tregut dhe Kapitulli 20).**

Grupi i Punës III, falë përvojës së ekspertëve, po shqyrton e diskuton tema në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit duke parashikuar një proces të mëtejshëm të reformave dhe pranimit në BE me fokus kapitujt e Acquis të BE - Kapitulli 11, Kapitulli 12 dhe Kapitulli 28. Në këtë Grup Pune po organizohen pesë Sesione. Këto sesione po bashkë-kryesohen nga përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe shoqëri civile dhe ekspertë të brendshëm të Konventës.

Në **sesionin e 5** i cili është dhe sesi i fundit për GP III i Konventës 2019-2021 i organizuar në bashkëpunim me **Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural** do të diskutohet sistemi FADN, roli i tij dhe eksperiencat sllovake në këtë fushë.

Ju lutemi gjeni këtu të dhënat e aktivitetit online në Platformën Zoom:

Link: <https://us02web.zoom.us/j/82349527280?pwd=TjN6V25GSWNqb0JlExZTGJUOFFGUT09>

Meeting ID: 823 4952 7280

Passcode: **Emaconv**

Ju lutemi të konfirmoni pjesëmarrjen tuaj, duke specifikuar si dëshironi ta ndiqni atë **fizikisht** apo **online** në: info@em-al.org. *Bazuar në rregullat e nxjerra anti-covid, për pjesëmarrjen fizike ju njoftojmë se numri është i kufizuar.*

* Gjatë aktivitetit do të ofrohet përkthim i njëkohshëm

PROGRAMI

Konventa për Integrimin European

Grupi i Punës III: (Bujqësia dhe Mbrojtja e Konsumatorit)

Sesioni 4, Tema: Themelimi, organizimi dhe funksionimi rrjetit të të dhënave të kontabilitetit në fermë (FADN)- praktikat më të mira nga Sllovakia

22 qershor 2021, 11:00 – 12:30

Format Hibrid - Grand Hotel Tirana / Platforma ZOOM

10:45-11:00 Regjistrimi i pjesëmarrësve

11:00-11:20 Hapje e aktivitetit

Florian Xhafa, anëtar i bordit të drejtorëve të Lëvizjes Europiane në Shqipëri (EMA)

Lauresha Grezda, Drejtore, Drejtorja e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

11:20-11:30 Përfundimet e nxjerra nga GP III - Bujqësia dhe Mbrojtja e Konsumatorit
Gledis Gjipali, Drejtori Ekzekutiv i EMA

11:30-12:10 Sistemi FADN në Slovaki – funksionimi dhe organizimi

Frantisek Huska, FADN në Sllovakia

Elena Sipova, FADN në Sllovakia

- Rregullorja dhe struktura organizative e Agjencisë Ndërlidhëse në Sllovakia
- Plani përzgjedhës për FADN – shtresëzimi i fermave
- Procesi i mbledhjes së të dhënave për FADN
- Përgatitja dhe funksionimi i softuerit të FADN

12:10-12:30 Diskutim i hapur dhe nxjerrja e rekomandimeve:

- **Agim Rrapaj**, Kryetar, Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar (KASH)
- Përfaqësues të institucioneve shtetërore
- Përfaqësues të komunitetit të agrobiznesit dhe fermerë
- Ekspertë nga universitetet dhe nga shoqëria civile